



Politika Kundër Ryshfetit dhe Korrupsionit

Tetor 2020

Tabela e Përmbajtjes

Qëllimi	2
Fushëveprimi dhe Zbatimi	2
Përgjegjësitë Tuaja	3
Ryshfeti dhe Korrupsioni	4
1. Përkufizimet	4
2. Parimet dhe Rregullat	5
Fushat ku korrupsioni dhe ryshfeti mund të ndodhin më së shpeshti	5
1. Shpenzimet për mikpritje, promocione dhe shpenzimet tjera të biznesit	5
2. Grantet, donacionet dhe kontributet	5
3. Pagesat e facilitimit	5
4. Pagesa të pavend nga palët e treta	6
Udhëzim për Procedurat Parandaluese	7
1. Vlerësimi i Rrezikut	7
2. Kujdesi i Duhur	7
3. Librat dhe Shënimet	7
4. Trajnimi dhe Komunikimi	7
5. Monitorimi dhe shqyrtimi	8
6. Si të paraqitet shqetësimi	8
Shkeljet	8
Shkurtimisht	9
Shtojca A	10
1. Legjislacioni kundër ryshfetit dhe korrupsionit	10

Qëllimi

Kjo Politikë Kundër Ryshfetit dhe Korrupsionit (“**Politika**”) ka për qëllim të rris vetëdijesimin dhe të siguroj pajtueshmëri me rregullat përkatëse që parandalojnë ryshfetin dhe korrupsionin.

Të gjithë drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e Grupit TITAN duhet të jenë në dijeni se çdo shkelje e rregullave për ryshfet dhe korrupsion, përveç se i vë ata para ndjekjes penale dhe/apo përgjegjësisë civile, mund gjithashtu të shkaktoj dëm të rëndë në reputacionin e TITAN-it si dhe të filialeve dhe degëve të saj.

Fushëveprimi dhe Zbatimi

Kjo Politikë zbatohet ndaj të gjithë individëve që punojnë në të gjitha nivelet dhe kategoritë, duke përfshirë drejtorët, menaxherët e lartë, zyrtarët dhe punonjësit (kolektivisht “**punonjësit**”) e Grupit TITAN, dhe nga të gjithë ata pritët të zbatojnë standardet më të larta të sjelljes profesionale dhe personale në të gjitha rrethanat.

Kjo politikë gjithashtu zbatohet ndaj personave të cilët kryejnë shërbime për apo në emër të cilitdo entitet të Grupit TITAN (“**persona bashkëpunëtorë**”), siç janë përfaqësuesit dhe agjentët.

Kjo politikë merret me një varg çështjesh që kanë të bëjnë me ryshfetin dhe korrupsionin. Aspektet tjera të etikës dhe korrupsionit në biznes, siç janë konfliktet e interesit, rregullohen ndaras.

Kjo Politikë përmban standardet globale të Grupit TITAN dhe është e harmonizuar me ligjet në fuqi. Në disa vende, ligjet dhe rregulloret e brendshme mund të jenë më rigorozë sesa parimet e përcaktuara në këtë dokument. Në raste të tilla, zbatohen rregullat më rigorozë.

Përgjegjësitë Tuaja



Secili punonjës i Grupit TITAN ka përgjegjësinë ta lexoj, kuptoj dhe zbatoj këtë Politikë.

Në fillim të punësimit tuaj me Grupin TITAN dhe përgjatë kohës së punësimit tuaj, do t'iu kërkohet të plotësoni dhe dorëzoni një deklaratë duke pranuar se e keni lexuar dhe kuptuar këtë Politikë.

Të gjithë punonjësit e Grupit TITAN **inkurajohen fuqishëm** të përdorin veglën e mësimit elektronik (e-learning) për sektorin privat mbi Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit dhe 10 parimet e Marrëveshjes Globale të Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, në faqen <http://thefightagainstcorruption.org>.

Ryshfeti dhe Korrupsioni

1. Përkufizimet

Ryshfet do të thotë ofrimi, dhënia, marrja apo premtimi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, i një dobie të parregullt për të ndikuar në dikë që të kryej një detyrë publike, tregtare apo ligjore në mënyrë jo të duhur. Kjo gjithashtu përfshinë tentimet për të kryer cilëndo nga të përmendurat më lartë.

Ryshfeti mund të shfaqet në forma të ndryshme. Kjo përfshinë çdo lloj dobie për pranuesin, për shembull, para të gatshme, huadhënie, dhurata, pagesë shkollimi, bursa, madje edhe punësimi i familjarit të dikujt apo dhurimi i bamirësisë në favor të tyre me qëllim jo të duhur, si dhe çdo lloj kontributi tjetër. Madje edhe praktikatat e zakonshme në biznes, si dhënia e dhuratave, sigurimi i zbavitjes dhe mikpritja, mund të përbëjnë ryshfet në raste të caktuara.

Pagesat e facilitimit janë pagesa që i bëhen një zyrtari publik apo qeveritar si stimulim që zyrtari të siguroj apo përshpejtoj veprimet rutinore, ligjore, qeveritare (“ndihmon në lëvizjes e procesit”) në dobi të palës e cila e bën pagesën dhe kjo është e ndaluar në mënyrë rigoroze.

Dhënia e ryshfetit një zyrtari të huaj publik është një vepër tjetër e kryer ku një person ofron, premtim apo i jep dobi financiare apo dobi tjetër një zyrtari të huaj publik me qëllim për të ndikuar në zyrtarin gjatë kryerjes së funksioneve të tij/saj zyrtare dhe për të siguruar apo mbajtur biznesin apo një dobi gjatë kryerjes së biznesit.

Zyrtar të huaj publik janë zyrtarët, punonjësit apo përfaqësuesit të cilësdo qeveri, entiteti në pronësi qeveritare, apo entiteti të kontrolluar nga qeveria kudo në botë, duke përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë dhe të ulët, qofshin të zgjedhur apo të emëruar, të cilët mbajnë një pozitë legjislative, administrative apo gjyqësore të çfarëdo lloji në një vend të huaj, duke përfshirë zyrtarët e agjencive apo ndërmarrjeve publike dhe zyrtarët apo agjentët e organizatave publike ndërkombëtare. Në disa juridiksione, si në Sh.B.A, këtu përfshihen edhe zyrtarët dhe kandidatët e partive politike. Çdo fëmijë, bashkëshort, prind apo motër/vëlla apo marrëdhënie tjetër familjare e një Zyrtari Qeveritar duhet të konsiderohet të jetë një Zyrtar Qeveritar për qëllime të kësaj Politike.

Nuk ka rëndësi se ku është kryer vepra. Shumica e vendeve kanë ligje të cilat e ndalojnë ryshfetin dhe korrupsionin. Këto fenomene shpesh kanë efekte përtej kufijve (ekstraterritorial), p.sh. shkojnë përtej kufijve të vendit, dhe mbulojnë veprat e kryera në një vend të huaj. Si shembull, Ligji i Sh.B.A-së për Praktika Korruptive në Vende të Huaja dhe Ligji për Ryshfetin i Mbretërisë së Bashkuar kanë juridiksion jashtë kufijve (ekstraterritorial) dhe mund të zbatohen në filialet e Grupit TITAN në tërë botën. Sipas këtij

fushëveprimi, mund të ndiqeni penalisht në Mbretërinë e Bashkuar për një vepër ryshfeti të kryer diku tjetër në botë.

2. Parimet dhe Rregullat

Të gjithë punonjësit apo personat bashkëpunëtorë të Grupit TITAN **duhet të zbatojnë** ligjet dhe rregulloret në fuqi të cilat ndalojnë ryshfetin dhe korrupsionin si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

Të gjithë punonjësit apo personat bashkëpunëtorë të Grupit TITAN **nuk duhet në asnjë rrethanë** të ofrojnë, kërkojnë, premtojnë, japin apo pranojnë ryshfet apo ndonjë pagesë tjetër të pavend, duke përfshirë pagesat e facilitimit.

Në Grupin TITAN pritet që të punojmë me **agjentë, furnizues, kontraktorë apo persona bashkëpunëtorë të cilët i zbatojnë të gjitha ligjet në fuqi** dhe të cilët me vullnet i bëjnë zotimet kontraktuale, aty ku është e realizueshme, për të treguar se i respektojnë rregullat përkatëse kundër ryshfetit dhe korrupsionit.

Fushat ku korrupsioni dhe ryshfeti mund të ndodhin më së shpeshti

1. Shpenzimet për mikpritje, promocione dhe shpenzimet tjera të biznesit

Si rregull e përgjithshme, ju nuk duhet të jepni dhurata, të ofroni zbavitje, apo mikpritje për apo t'i pranoni të njëjtat, nga një zyrtar qeveritar apo zyrtar tjetër publik, apo nga anëtarët e familjeve të tyre dhe/apo bashkëpunëtorët e tyre të biznesit, në lidhje me kryerjen e detyrave tuaja. Nëse është e duhur dhe e lejuar me ligjet e brendshme, mund të ofroni apo pranoni vetëm dhurata jo-monetare të një vlerë të parëndësishme që rrjedhin nga praktika e zakonshme e biznesit.

2. Grantet, donacionet dhe kontributet

Kontributet e bëra nga entitetet e Grupit TITAN për palët e interesuara në shoqëri duhet gjithmonë të bëhen në një mënyrë transparente dhe të hapur, në pajtim me ligjet e brendshme dhe nuk duhet të shkaktojnë asnjë pritshmëri për shpërblim apo për ndonjë kontratë apo licencë.

3. Pagesat e facilitimit

Grupi TITAN **nuk lejon që të bëhen pagesa të facilitimit**, madje edhe nëse pagesat e tilla janë nominale në shumë apo ligji i brendshëm i lejon ato.

4. Pagesa të pavend nga palët e treta

Për të siguruar që të mos ndodh ryshfeti, është me rëndësi të kryhet **kujdesi i duhur (due diligence) i plotë para përzgjedhjes së personave bashkëpunëtorë të cilët do të veprojnë për Grupin TITAN.**

Për këtë qëllim, inkurajoheni të punoni vetëm me individë apo kompani të kualifikuara dhe me reputacion.

Duhet pasur kujdes të veçantë gjatë vlerësimit të një pale të tretë të mundshme e cila do të mund të ndërveprojë me qeverinë në emër të Grupit TITAN.

Nëse individi apo kompania është nga një shtet me rrezik të lartë në të cilin vend dihet se ndodh ryshfeti, hetimi juaj për atë individ apo kompani duhet të jetë i plotë.

Duhet gjithashtu të siguroni që kompensimi të jetë i arsyeshëm duke marrë parasysht shërbimet.

Në çdo rast, inkurajoheni të hyni në marrëdhënie me personat bashkëpunëtorë të cilët janë të gatshëm të nënshkruajnë një kontratë me dispozita të cilat theksojnë se ata nuk kryejnë dhe nuk do të angazhohen në ryshfet.

Udhëzimi për Procedurat Parandaluese

1. Vlerësimi i Rrezikut

Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut të cilat mundësojnë identifikimin e ekspozimit ndaj rreziqeve potenciale të jashtme dhe të brendshme nga ryshfeti apo korrupsioni, duhet të bëhen në mënyrë periodike nga Departamenti i Grupit për Pajtueshmërinë dhe Kundër-Mashttrimin, në bashkëpunim me menaxhmentin lokal. Vlerësimi dhe konkluzionet e saj duhet të dokumentohen në mënyrë të duhur.

2. Kujdesi i Duhur

Siç është shënuar më lartë, është përgjegjësia jonë të ndërmarrim një qasje proporcionale dhe të bazuar në rrezik, sa i përket personave të cilët kryejnë apo do të kryejnë shërbime për apo në emër të Grupit TITAN. Secila fazë e hetimit gjatë kujdesit të duhur duhet të dokumentohet.

3. Librat dhe Evidenca

Duhet të mbahen të dhëna të detajuara dhe të sakta të kontabilitetit për të gjitha transaksionet dhe të gjitha pagesat dhe shpenzimet të cilat duhet të përmbajnë detaje të mjaftueshme, saktësi rigoroze dhe që janë të plota dhe në asnjë rrethane nuk duhet asnjëherë të fshihen apo të keq-klasifikohen me qëllim.

Duhet të mbahet evidenca me shkrim për të gjitha dhuratat e ofruara të cilat kalojnë shumën prej dyqind euro (200 €) apo të barasvlershme me të. Asnjë llogari nuk duhet të mbahet “jashtë librit” për të lehtësuar apo fshehur pagesat e parregullta.

Duhet të sigurojmë se mbajmë libra, evidencë të saktë si dhe procedura të sakta për raportim financiar në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi për tatim dhe fusha të tjera.

4. Trajnimi dhe Komunikimi

Të gjithë punonjësit aktual që punojnë në vende të cilat perceptohen se janë me rrezik të lartë si rezultat i ligjeve në fuqi, do të marrin trajnim të rregullt dhe përkatës se si të zbatohet kjo politikë.

Qasja jonë zero-tolerancë ndaj ryshfetit dhe korrupsionit duhet tu bëhet me dije të gjithë furnizuesve, kontraktorëve, agentëve dhe partnerëve në biznes në fillim të marrëdhënieve tona me ata dhe sipas nevojës.

5. Monitorimi dhe shqyrtimi

Auditimi i Brendshëm dhe/apo Përgjegjësia Sociale e Korporatës (CSR) duhet të monitoroj dhe shqyrtoj efikasitetin dhe zbatimin e kësaj Politike. Çdo përmirësim i identifikuar duhet të bëhet sa më parë. Kjo Politikë mund të plotësohet kur të konsiderohet e nevojshme nga Departamenti Ligjor i Grupit.

6. Si të paraqitet shqetësimi

Inkurajoheni të paraqitni shqetësime për çdo çështje apo dyshim për praktikë të keqe e cila përbën shkelje të kësaj Politike. Nëse besoni apo dyshoni se do të ndodh, është duke ndodhur apo ka ndodhur shkelje korruptive (për shembull, nëse një klient ekzistues apo potencial u thotë juve se duhet të jepet një dhuratë apo të bëhet një pagesë për të bërë biznes me ne), raportojeni këtë menjëherë tek:

- Menaxheri Juaj i Drejtpërdrejt dhe/apo
- Departamenti Juaj Ligjor apo
- Platforma për raportim (EthicsPoint)

Nëse keni ndonjë pyetje apo kërkonit sqarime në lidhje me këtë Politikë, ju lutem kontaktoni menaxherit tuaj të drejtpërdrejt dhe/apo Departamentin tuaj Ligjor.

Është përgjegjësi e të gjithë punonjësve në kuadër të fushës së përgjegjësisë së tyre funksionale që të zbatojnë këtë Politikë dhe të sigurojnë se do ta përdorin për të treguar për çdo rrezik të dyshuar apo keq-bërje.

Të gjithë menaxherët duhet të udhëheqin me shembull, dhe duhet tu japin udhëzime punonjësve të cilët u raportojnë atyre. Çdokush që raporton për një shkelje të mundshme të ligjeve në fuqi apo të kësaj Politike do të mbrohet nga çfarëdo formë e kundërpërgjigjes/hakmarrjes së mundshme.

Shkeljet

Ryshfeti dhe Korrupsioni janë vepra penale. Si punonjës i Grupit TITAN do të jeni personalisht përgjegjës për veprimet tuaja pavarësisht se a keni paguar ju vetë ryshfet apo e keni autorizuar, keni ndihmuar, apo nxitur dikë tjetër për të shkelur ligjin kundër korrupsionit apo ryshfetit.

Përveç ndjekjes penale apo padisë civile për dëme, çdo shkelje e kësaj Politike mund të rezultojë në veprim disiplinor, duke përfshirë ndërprerjen e punësimit.

Shkurtimisht

- Njihni Rregullat
- Merrni vendime të drejta
- Paraqituni / lajmërohuni vullnetarisht

Shtojca A

1. Legjislacioni kundër ryshfetit dhe korrupsionit

- Ligji për Praktika Korruptive në Vende të Huaja (FCPA)
<http://www.justice.gov/criminal-fraud/foreign-corrupt-practices-act>
- Ligji për Ryshfetin i Mbretërisë së Bashkuar i vitit 2010
http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2010/23/pdfs/ukpga_20100023_en.pdf
- Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i “Transparency International”
<http://www.transparency.org/research/cpi/overview>